



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 169 / Prot. Datë 30.10.2019  
/2

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 2897 / Prot. Datë 04.11.2019  
/2

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE DHE PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

## **1. Qëllimi**

Në përputhje me objektin e veprimtarisë së dy institucioneve, Institutit të Statistikave, në vijim referuar si “INSTAT” dhe Prokurorisë së Përgjithshme, në vijim referuar si “PP”, lidhet ky memorandum mirëkuptimi;

Duke patur parasysh se, Instituti i Statistikave është institucioni që prodhon pjesën kryesore të statistikave zyrtare, si dhe monitoron veprimtarinë statistikore të agjencive statistikore dhe institucioneve të tjera që disponojnë, krijojnë, përditësojnë dhe mirëmbajnë të dhënat administrative, në interes të zbatimit të Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare;

Duke vlerësuar faktin se, Sistemi Kombëtar Statistikor bazohet në një bashkëpunim të ngushtë mes INSTAT-it nga njëra anë dhe agjencive të tjera statistikore dhe mbajtësve të të dhënave administrative nga ana tjetër;

Me qëllim, rritjen e performancës së funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, duke rregulluar mënyrën e organizimit të punës, transmetimit të të dhënave, përgjigjen në kohë dhe në mënyrën e përshtatshme të kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për informacion statistikor si dhe detyrimet e ndërsjellta në kuadër të bashkëpunimit të dy institucioneve nënshkruese, “INSTAT” dhe “PP”;

Përgjegjësia dhe detyrimi i pjesëmarrësve për bashkëpunim, mbështetet në:

legjislacionin kombëtar në fuqi, që normon përkatësisht punën e të dy institucioneve, “INSTAT” dhe “PP”, si dhe në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, konkretisht sa më poshtë;

Në ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”;

Në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

Në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;

Duke respektuar Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane;

“INSTAT” dhe “PP” bien dakord si vijon:

### **1. Përcaktimi i përgjegjësive**

#### **1.1 Detyrime të Prokurorisë së Përgjithshme**

1. PP merr përsipër të zbatojë parimet e besueshmërisë, paanshmërisë dhe objektivitetit të të dhënave statistikore.

2. PP garanton disponibilitetin e burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky Memorandum Bashkëpunimi si dhe ndërmerr veprimtari të tjera që ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës së prodhimit statistikor brenda institucionit.

## **1.2 Detyrime të Institutit të Statistikave**

1. INSTAT përcakton përkufizimet dhe klasifikimet statistikore si dhe nxjerr udhëzime e manuale për standardet profesionale që duhet të zbatohen gjatë kryerjes së proceseve të prodhimit statistikor në përputhje me ligjin për statistikën zyrtare.
2. Udhëzimet për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Aneksin bashkëngjitur këtij memorandumi, propozohen nga Grupi i punës sipas nenit 2 të këtij Memorandumi dhe miratohen nga të dy palët.
3. INSTAT furnizon PP pa pagesë me publikimet statistikore që prodhon institucioni.

## **2. Organizimi i bashkëpunimit**

1. Me qëllim që të sigurohet zbatimi i këtij Memorandumi, brenda një muaji nga data e nënshkrimit të tij krijohet një grup pune përgjegjës për të koordinuar aktivitetet e palëve.
2. Grupi i Punës përbëhet nga të paktën 4 anëtarë të zgjedhur me pëlqimin e titullarëve të institucioneve, duke siguruar pjesëmarrje të barabartë mes palëve.
3. Grupi i punës mbledhet të paktën çdo tre muaj ose kur kërkohet nga njëra palë. Në mbledhjet e tij, Grupi i Punës mund të ftojë të marrin pjesë ekspertë teknikë ose funksionarë të tjerë që kanë lidhje apo mund të japin mendim për çështje të ndryshme brenda objektit të punës.
4. Grupi i punës kryen këto detyra:
  - a) monitoron zhvillimin e aktiviteteve të përcaktuara duke verifikuar në çdo fazë përputhjen mes objektivave dhe rezultateve të arritura;
  - b) kërkon zbatimin e afateve për shkëmbimin e informacionit dhe tërheq vëmendjen për vonesat apo keqfunksionimin e zbatimit të detyrave;
  - c) përcakton shkaqet dhe pengesat që ndalojnë arritjen e plotë të rezultateve të pritshme;
  - d) paraqet propozime për zgjidhjen e problemeve, duke përfshirë edhe ndryshimet e mundshme të Memorandumit dhe anekseve pjesë integrale të tij, si dhe ia paraqet për miratim titullarëve, sipas të njëjtës procedurë që ndiqet për nënshkrimin e këtij memorandumi;
  - e) propozon iniciativa specifike për rritjen profesionale të statisticienëve nëpërmjet kurseve të trajnimit, pjesëmarrjes në takime pune me organizatat partnere brenda

- dhe jashtë vendit, pjesëmarrjes në konferenca, seminare dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me prodhimin statistikor;
- f) propozon fillimin e projekteve kërkimore dhe studimore në sektorë të veçantë të interesit të përbashkët;
  - g) ndërmerr iniciativa për të mbështetur zbatimin korrekt të të drejtës së hyrjes dhe shkëmbimit të të dhënave;
  - h) krijojnë procedura të ngushta bashkëpunimi edhe nëpërmjet një rrjeti joformal kontaktesh të përhershme pune, me qëllim që të përgatisin zgjidhje të përbashkëta të pranuar në nivel teknik.

### **3. Shkëmbimi i të Dhënave dhe informacionit**

- 1. Të dhënat që shkëmbehen, forma dhe periodiciteti i transmetimit përcaktohen në mënyrë të detajuar në Aneksin pjesë përbërëse të këtij Memorandumi.
- 2. Transmetimi i të dhënave kryhet pa pagesë.
- 3. INSTAT garanton mbështetjen teknike dhe metodologjike për zbatimin e duhur të Memorandumit.
- 4. PP koordinon me prokuroritë e shkallës së parë për dhënien e informacionit statistikor të kërkuar nga INSTAT.
- 5. Të dhënat e transmetuara nga PP tek INSTAT trajtohen si të dhëna konfidenciale dhe administrohen duke respektuar në mënyrë rigorozë dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe nenin 31 “Konfidencialiteti” i ligjit të statistikave.

### **4. Përditësime**

- 1. Udhëzime mbi standardet profesionale dhe të dhënat që do të shkëmbehen, duhet të përditësohen në përputhje me teknikat elektronike si dhe praktikën e krijuar gjatë zbatimit këtij memorandumi.
- 2. Kur është e nevojshme palët përshtatin Aneksin duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet e paraqitura nga Grupi i Punës sipas këtij Memorandumi.

### **5. Të tjera**

- 1. Ky Memorandum lidhet për një kohë të pacaktuar dhe mund të ndryshohet me bashkëpunimin e të dy palëve.
- 2. Secila palë mund ta përfundojë Memorandumin duke lajmëruar me shkrim palën tjetër 30 ditë para.

3. Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim. Në rast se nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë, atëherë Memorandumi konsiderohet i përfunduar dhe i zgjidhur për të gjitha efektet.
4. Ky Memorandum hyn në fuqi dhe bëhet efektiv me nënshkrimin e tij.
5. Memorandumi hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë.

**PËR:**

**PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

**PROKUROR I PËRGJITHSHËM**

**ARTA MARKU**

**Data:** 04/10/2019



**PËR:**

**INSTITUTIN E STATISTIKAVE**

**ZËV/KRYETAR BORDI DREJTUES**

**ELSA DHULI**

**Data:** 29/10/2019



## **ANEKS**

### **Të dhënat që do të sigurojë Prokuroria e Përgjithshme**

- 1. Të dhëna në nivel rekordi të detajuar për veprat penale, për fushat respektive të paraqitura më poshtë me frekuencë vjetore:**
  - a. Procedime penale të regjistruara;
  - b. Procedime penale për gjykim;
  - c. Persona të pandehur për veprat penale sipas gjinisë dhe grupmoshës;
  
- 2. Të dhëna për procedimet penale të përfunduara sipas specifikimeve të mëposhtme me frekuencë vjetore:**
  - a. Numri total i procedimeve të pezulluara;
  - b. Numri total i procedimeve të pushuara;
  - c. Numri total i procedimeve të dërguara në gjykatë;
  - d. Numri total i procedimeve të transferuara.
  
- 3. Të dhëna sipas prokurorive të shkallës së parë sipas zërave të mëposhtëm me frekuencë vjetore:**
  - a. Procedime penale të regjistruara për periudhën vjetore;
  - b. Procedime penale dërguar për gjykim për periudhën vjetore;
  - c. Persona të pandehur sipas gjinisë, grupmoshës për periudhën vjetore.

Tabela1 : Treguesit për procedimet penale dhe të pandehurit sipas periodicitetit dhe disagregimit.

<b>Treguesi</b>	<b>Periodiciteti</b>	<b>Disagregimi</b>
<b>Procedime penale</b>		
Procedime penale të regjistruara	vjetor	nenet e Kodit penal, prokurori të shkallës së parë
Procedime penale për gjykim	vjetor	nenet e Kodit penal, prokurori të shkallës së parë
<b>Të pandehur</b>		
Të pandehur	vjetor	nenet e Kodit penal, prokurori të shkallës së parë, gjinia, mosha
<b>Procedime penale të përfunduara</b>		
Procedime të pezulluara	vjetor	total
Procedime të pushuara	vjetor	total
Procedime për gjykim	vjetor	total
Procedime të transferuara	vjetor	total

### **Shkëmbimi i të dhënave dhe periodiciteti**

Të dhënat që aksesohen dhe shkëmben mes palëve kanë formë përfundimtare ose paraprake (sipas rastit). Në secilin rast të cituar, forma e dokumentit duhet të parashikohet shprehimisht në formatin mbajtës të tij.

Formatet e shkëmbimit të të dhënave janë në formë shkresore, në format elektronik ose kombinim i këtyre dy formave, në përputhje me kërkesën e palës së interesuar.

Dërgimi i të dhënave për vlerësimin e këtyre treguesve do të jetë në bazë vjetore.